



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 37 Prot.

Tiranë, më 09. 01. 2024

**V E N D I M**

**Nr. 10, datë 09. 01. 2024**

Mbështetur në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup> shqyrtoi ankesën nr. 111 Regj., datë 07.06.2023, e subjektit ankues E. Xh., kundër Bashkisë Vlorë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë/MFE, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “*gjendjes arsimore*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Bazuar në parashtrimet e dokumentacionin e depozituar nga subjekti ankues, E. Xh., rezulton se ajo punon si edukatore në një kopsht fëmijësh në Bashkinë e Vlorës prej rreth 7 vitesh. Në 2016 ka lidhur kontratën e punës me punëdhënësin me afat të caktuar. Që prej datës 03.10.2017, ankuesja thekson se është paguar me pagë grupi 14000 lekë. Ajo shprehet se në muajin shkurt të vitit 2023, Bashkia Vlorë ka ulur pagën e grupit nga 14000 lekë në 11000 lekë, me pretendimin se kjo bëhej në zbatim të VKM-së nr. 175, datë 08.03.2017 “*Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar*”.

Ankuesja parashtron se: “*Mendoj se kjo VKM, po interpretohet në mënyrë të pasaktë nga Bashkia Vlorë, sepse nga komunikime me mësuese në qytete të tjera, paga e grupit është në bazë të nivelit të diplomës. Dy mësuese kolege tonat në Tiranë paguhen për të njëjtin pozicion pune me pagë grupi 14000 lekë*”.

Ankuesja thekson se ndihet e diskriminuar në krahasim me pjesën tjetër të mësuesve/edukatoreve, pasi kjo situatë është krijuar vetëm në Vlorë. Njëherësh ankuesja pretendon se punëdhënësi ka shkelur

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

detyrimin kontraktual, duke ulur nivelin e pagës, pa e njoftuar paraprakisht në rrugë zyrtare, duke e trajtuar në mënyrë të pafavorshme dhe të padrejtë.

Sakaq, E. Xh. ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që në përfundim të shqyrtimit të ankesës, të konstatojë diskriminim nga institucionet përgjegjëse dhe të ndërmarrë masat efektive për të ndrequr pasojat e ardhura për shkak të veprimeve diskriminuese kundrejt saj.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>2</sup>, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “*gjendjes arsimore*”, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7, i LMD-së, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre”.

Në Kreun II, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ky ligj në nenin 12, të tij parashikon se: “1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji.....”.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

Bazuar në nenin 32/1/a të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 691/1, datë 16.06.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga subjekti, për ankesën e bërë nga E. Xh. si dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:
  - Kopje të Kontratës/ve Individuale të Punës me subjektin ankues.
  - Kopje të akteve të dosjes personale të ankueses.
  - Kopje të Kontratës Kolektive, nëse ka.
  - Kopje të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Vlorë.
  - Parashtrimet tuaja lidhur me momentin e ndryshimit të pagës së grupit për punonjëset/edukatore të arsimit parashkollor, në Bashkinë Vlorë, nga 14.000 lekë në 11.000 lekë. Argumenti juaj se përse u reflektua ky ndryshim në muajin shkurt 2023, ndërkohë që VKM-ja nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, kishte efekt veprues që nga data 01.03.2017.
  - A është njoftuar ankuesja lidhur me ndryshimin e masës së pagës së grupit?
  - A është nënshkruar kontratë e re individuale pune me ankuesen, pas ndryshimit të elementit pagë, nga ana e punëdhënësit?
  - Informacion nëse ankuesja është ankuar për ndryshimin/uljen e pagës pranë punëdhënësit.
  - Informacion nëse E. Xh. është ankuar për diskriminim pranë punëdhënësit.

Nga ana e Ministrive Përgjegjëse (MFE, MAS) kërkohet:

- Informacion dhe parashtrime lidhur me mënyrën e zbatimit të VKM nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, në kuadër të pretendimeve të subjektit ankues.

Me shkresën<sup>3</sup> nr. 3836/1, datë 22.06.2023, Ministria e Arsimit dhe Sportit, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Në ligjin nr. 69, datë 21.06.2012 “Për Sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 2, pika 1, përcaktohen nivelet arsimore të arsimit parauniversitar si vijon: *Arsimi parauniversitar përfshin nivelet arsimore me*

<sup>3</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 691/2 prot., datë 23.06.2023

*kodet 0, 1, 2 dhe 3, sipas “Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Arsimit”, të miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s, në sesionin e 29-të të saj, në nëntor 1997 përkatësisht:*

- a) “Niveli me kodin 0”, arsimit parashkollor;*
- b) “Niveli me kodin 1”, arsimit fillor;*
- c) “Niveli me kodin 2”, arsimit mesëm i ulët;*
- ç) “Niveli me kodin 3”, arsimit mesëm i lartë.*

*Arsimi parashkollor synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen për arsimin fillor. Arsimit parashkollor ndiqet nga fëmijët e moshës nga tre deri në gjashtë vjeç. Fëmijëve të moshës pesë vjeç u mundësohet ndjekja e klasës përgatitore edhe pranë shkollave të arsimit bazë, me synim integrimin në arsimin e detyruar. Arsimit parashkollor ofrohet nga kopshti, si institucion arsimor.*

*Bazuar në ligjin nr. 139/2015, “Për qeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 23, pika 12, bashkitë janë përgjegjëse për administrimin dhe rregullimin e sistemit parashkollor në kopshte dhe çerdhe.*

*Me urdhrin e Kryeministrit nr. 127, datë 16.09.2015 “Për marrjen e masave në kuadër dhe në funksion të zbatimit të strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore”, numri i punonjësve mësimorë, edukatorë të arsimit parashkollor, numri i punonjësve të shërbimeve në arsimin parauniversitar, si dhe fondet për mbulimin e shpenzimeve të punonjësve mësimorë, edukatorë të arsimit parashkollor, punonjësve të shërbimeve në arsimin parauniversitar, janë transferuar pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore.*

*Ligji nr. 69/2012, përpara miratimit të ndryshimeve me ligjin nr. 48/2018, në nenin 57, pika 1, germa a), përcaktonte: Neni 57:*

- 1. Mësuesi në institucionin arsimor duhet të ketë fituar diplomën e mëposhtme në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të: a) Mësuesi i arsimit parashkollor: diplomë universitare të ciklit të parë të studimeve universitare Bachelor.*

*Me ndryshimet e ligjit nr. 69/2012, të miratuara me ligjin nr. 48/2018, datë 23.7.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet që mësuesi për arsimin parashkollor duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë “Bachelor”, që formon mësues të arsimit parashkollor. Pra, duke filluar nga viti 2018 e në vazhdim, bazuar në ligjin nr. 48/2018, datë 23.07.2018, neni 57, pika 1, germa a), një kandidat për tu pranuar, emëruar dhe punësuar si mësues i arsimit parashkollor, dmth në kopsht duhet të zotërojë diplomën e ciklit të parë “Bachelor”, në mësues për arsimin parashkollor.*

*Ndërsa sipas pikave 2-5, të nenit 57, të ligjit nr. 69/2012, për të ushtruar profesionin e rregulluar të mësuesit të arsimit fillor, arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë, së pari kërkohet që të ketë ndjekur dhe përfunduar arsimin e lartë në dy ciklet e studimit duke fituar një diplomë të ciklit të parë dhe një diplomë të ciklit të dytë, më pas të kryej praktikën profesionale si dhe të kaloj*

*me sukses provimin e shtetit në fushën e formimit të tij, siç parashikohet në ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.*

*Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk mund të paraqesë parashtrime për mënyrën e zbatimit të VKM nr. 175, datë 08.03.2017, lidhur me rastin konkret pasi subjekti ankues punon në kopsht, pra në një institucion arsimor të arsimit parashkollor, i cili rregullohet dhe administrohet nga Bashkia Vlorë...”.*

*Në përgjigje të shkresës së Komisionerit, Bashkia Vlorë përmes shkresës nr. 7316/1, datë 11.07.2023, informoi ndër të tjera se: “Bashkia Vlorë, nisur nga ankesat e disa edukatoreve të emëruara pas datës 01.03.2017, me pretendimin e pabarazisë në nivelin e pagës, i është drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për interpretim të VKM-së nr. 175, me shkresat nr. 1024 datë 25.01.2023 dhe nr. 1024/2, datë 16.03.2023. Ministria e Arsimit dhe Sportit ka kthyer përgjigje me shkresat nr. 1024/1, datë 08.02.2023 dhe nr. 1024/3, datë 29.03.2023.*

*Për këtë arsye, ndryshimi në pagë është reflektuar në muajin Shkurt 2023, pas kthimit të përgjigjes nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.*

*Ankuesja është njoftuar në një takim të zhvilluar në Bashkinë Vlorë për ndryshimin në pagë, bazuar në kthimin e përgjigjes nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, sipas shkresave bashkëlidhur.*

*Në bazë të Udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar, kontrata individuale e punës nënshkruhet nga drejtuesi i institucionit arsimor dhe punëmarrësi.*

*E. Xh. nuk është ankuar për diskriminim pranë punëdhënësit, por ka kërkuar shpjegime mbi ndryshimet në pagën e grupit....”.*

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 691/3, datë 30.08.2023 njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 12.09.2023, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

*Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.*

*Seanca u zhvillua në datë 12.09.2023, në mungesë të përfaqësuesve të Bashkisë Vlorë dhe në praninë e subjektit ankues dhe të përfaqësuesve me autorizim<sup>4</sup> të: Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (M. R dhe D. H) dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (A. U).*

---

<sup>4</sup> Respektivisht: Autorizim me nr. 5474/1, datë 06.09.2023 e MASR-së, Autorizim me nr. 15670/1, datë 11.09.2023, të MFE-së.

Nga ana e përfaqësuesit të MFE-së u mbajt qëndrimi se, institucioni që ai përfaqëson nuk duhet të ishte palë në këtë proces, me arsyetimin se edukatorët kanë varësi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Bashkia Vlorë. Në këtë kontekst ai mbajti qëndrimin se interpretimin e këtij akti, VKM-së mbi të cilën përcaktohet dhe paga e ankuses, e bën vetë institucioni që e zbaton atë. Pra, Bashkia duhet të japë dhe shpjegimin se pse e zbaton në këtë mënyrë aktin në fjalë.

Përfaqësueset e MAS-it, u shprehen se:

*“VKM-ja përcakton nivelet e pagave që duhet të marrin edukatorët dhe mësuesit në bazë të diplomës. Edukatorët kanë detyrim të kenë gradën “Bachelor”, mësueset duhet të kenë gradën “Master Shkencor”. Mësuesit duhet të kryejnë edhe trajnimet profesionale dhe provimin e shtetit. VKM-ja përcakton se kush është punësuar mbas datës 01.03.2017, do të paguhet me 11.000 lekë”.*

Në përfundim të seancës, palëve iu bë e ditur se mund të depozitonin në vijim të seancës, parashtrime, prova e fakte të tjera shtesë të cilat mbështesnin pretendimet e tyre.

- Në vijim të seancës dëgjimore, nëpërmjet shkresës me nr. 660/4 prot., datë 26.09.2023, Komisioneri iu drejtua Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë Vlorë, duke kërkuar prej secilit institucion informacionin si më poshtë citojmë:

Nga ana e Këshillit të Ministrave:

- Informacion/relicion shpjegues lidhur me arsyet e diferencimit të mësuesve/edukatorëve për përfitimin e pagës së grupit sipas VKM-së nr. 175, datë 08.03.2017 *“Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”.*
- Arsyet e vendosjes së këtij diferencimi, që lidhet me datën e zbatimit të VKM-së nr. 175, datë 08.03.2017.

Nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit kërkohet:

- Referuar faktit që Ministria e Arsimit dhe Sportit është përgjegjëse për zbatimin e VKM-së me nr. 175, datë 08.03.2017 *“Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”*, a është kryer ndonjë monitorim lidhur me zbatimin e saj?

Nga ana e Bashkisë Vlorë, kërkohet:

- Informacion mbi numrin e përgjithshëm të punonjësve/edukatorë në kopshtet që mbulon Bashkia Vlorë. Sa prej tyre janë emëruar përpara vitit 2017 dhe sa prej tyre pas këtij viti?
- Informacion lidhur me numrin e punonjësve/edukatorë të cilëve u është ulur paga e grupit dhe sa prej tyre jo. Nëse ka raste që nuk u është ulur paga e grupit, të specifikohen arsyet lidhur me të, për secilin prej tyre.



- A ka punonjëse/edukatore që janë transferuar pas vitit 2017 nga bashki të tjera apo brenda kopshteve të Bashkisë Vlorë dhe paga grupit për ta ka mbetur e pandryshuar? Nëse po, të jepen arsyet e mosndryshimit të pagës së grupit për secilin prej tyre.
- Informacion lidhur me arsyet përse u vendos ndryshimi i pagës së grupit për punonjëset/edukatore të arsimit parashkollor, në Bashkinë Vlorë, nga 14000 lekë në 11000 lekë, në muajin shkurt 2023, ndërkohë që VKM-ja nr. 175, datë 08.03.2017 *“Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”*, kishte efekt veprues që nga data 1 mars 2017.

Nëpërmjet shkresës<sup>5</sup> me nr. 6079/1 prot., datë 03.10.2023, lidhur me sa më sipër, u përgjigj vetëm MASR, e cila ndër të tjera, u shpreh se:

*“Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për qeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 23, pika 12, e tij, bashkitë janë përgjegjëse për administrimin dhe rregullimin e sistemit parashkollor në kopshte e çerdhe.*

*Me Urdhrin e Kryeministrit me nr. 127, datë 16.09.2015 “Për marrjen e masave në kuadër dhe në funksion të zbatimit të strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore”, numri i punonjësve mësimorë, edukatorë të arsimit parashkollor, numri i punonjësve të shërbimeve në arsimin parauniversitar, si dhe fondet për mbulimin e shpenzimeve të punonjësve mësimorë, edukatorë të arsimit parashkollor, punonjësve të shërbimeve në arsimin parauniversitar, janë transferuar pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore.*

*Sipas pikës 2, të kreut 12, të Udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit dhe të mësuesit në dispozicion nga një vend pune, si dhe administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, të ndryshuar, për mësuesit në institucionet parashkollore, njësitë e vetëqeverisjes vendore, kryejnë procedurat e emërimit duke respektuar renditjen në portalin “Mësues për Shqipërinë”.*

*Për sa më sipër, sqarojmë se MAS nuk kryen monitorime në lidhje me zbatimin e VKM nr. 175, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, përsa i përket strukturës së pagës të mësuesve të arsimit parashkollor”.*

Nëpërmjet shkresës me nr. 660/6, datë 06.11.2023, Komisioneri, iu drejtua sërish nëpërmjet një kujtese, Këshillit të Ministrave dhe Bashkisë Vlorë, lidhur me dërgimin e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar prej tij.

Referuar dokumentit, Lajmërim marrje poste nr: RR 458 920 723 AA, rezulton se shkresa sipërcituar është marrë në dorëzim nga Këshilli i Ministrave, i cili ka marrë dijeni për shkresën e mësipërme, në kushtet kur dokumenti është nënshkruar nga punonjësi i këtij institucioni, ashtu dhe nga nëpunësi i shërbimit postar.

<sup>5</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 660/5 prot., datë 05.10.2023

Në vijim, Këshilli i Ministrave, pavarësisht faktit që ka marrë informacion, lidhur me shkresën e sipërcituar, nuk ka depozituar asnjë dokument apo parashtrim lidhur me sa ka kërkuar Komisioneri në kuadër të shqyrtimit të ankesave në fjalë.

Nëpërmjet shkresës me nr. 13670/1, datë 14.11.2023, Bashkia Vlorë, dërgoi informacionin si vijon:

*“Në lidhje me informacionin e kërkuar, Bashkia Vlorë i është drejtuar MAS për interpretimin e VKM-së me nr. 175/2017 dhe ka mbajtur një korrespondencë vijuese lidhur me këtë fakt.*

*Problematika është evidentuar pas emërimit të një edukatoreje në Kopshtin nr. 2, nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”, e cila më parë ka qenë e emëruar në institucionet arsimore parashkollore në Bashkinë Berat.*

*...Kontrata e punësimit lidhej dhe vazhdon të lidhet midis drejtueses së institucionit arsimor dhe edukatores. Nga Bashkia Vlorë bëhet vetëm pagesa, e bazuar në listëprezencën e dorëzuar nga institucioni arsimor”.*

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara*



*të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.*

**A. Lidhur me pretendimin e subjektit ankues, për trajtim të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Vlorë.**

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me shtetas/individë të tjerë në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”. Në këtë kontekst, në ankesën në fjalë, është analizuar dhe vlerësuar nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë, pabarabartë e të pafavorshme nga Bashkia Vlorë, (në kuadër të legjitimitit si institucioni përgjegjës dhe kompetent lidhur me pagën e punonjësve të arsimit parashkollor/edukatorëve) si dhe si është trajtuar nga VKM nr. 175, datë 08.03.2017 “*Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë, në arsimin parauniversitar*”, të ndryshuar, krahasuar me edukatoret, të cilat kanë filluar marrëdhënien e punës para datës 01.03.2017.

*Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:*

Komisioneri ka vlerësuar dhe analizuar objektin e kësaj ankese, lidhur me pretendimin e ankueses për uljen e pagës së grupit nga 14.000 lekë në 11.000 lekë, së pari, duke analizuar nëse veprimet e Bashkisë Vlorë janë të drejta, në përputhje me parashikimet ligjore (VKM-në përkatëse), përsa i takon uljes së pagës së grupit për ankuesen (e cila ka qenë e punësuar si edukatore me kontratë me afat të caktuar në kopshtin e Njesisë Administrative Orikum dhe më pas ka lidhur kontratën e punës pas datës 01.03.2017 me Kopshtin nr. 3, Vlorë) dhe së dyti, nëse konstatohet një gjë e tillë, atëherë Komisioneri do të vlerësojë, nëse ky trajtim dhe arsyet e diferencimit të mësuesve/edukatorëve për përfitimin e pagës së grupit sipas VKM-së nr. 175, datë 08.03.2017 “*Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë, në arsimin parauniversitar*”, së ndryshuar, janë objektive, të justifikuar dhe të arsyeshme, lidhur me shkakun e pretenduar.

**A.1 Lidhur me zbatimin e VKM-së nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë, në arsimin parauniversitar”, së ndryshuar, nga ana e Bashkisë Vlorë.**

Nga aktet e administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës rezultoi se:

Referuar Librezës së Punës së E. Xh., rezulton se ankuesja nga data 01.12.2016 deri në datë 23.08.2017 ka qenë e emëruar si edukatore në Kopshtin e Njesisë Administrative Orikum, Vlorë, me kontratë me afat të caktuar.

Pak kohë pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës më datë 23.08.2017, me Kopshtin Orikum, nëpërmjet shkresës datë 02.10.2017, subjekti ankues ka nënshkruar Kontratën Individuale të Punës me Drejtorinë e Kopshtit Nr. 3, Bashkia Vlorë, me afat të caktuar, për periudhën 02.10.2017-

02.10.2018, në pozicionin “Edukatore”. Në përfundim të afatit të saj, ankuesja ka nënshkruar Kontratën Individuale të Punës me afat të pacaktuar me Kopshtin Nr. 3, Bashkia Vlorë.

Nga deklaratimet dhe dokumentacioni i depozituar nga palët është pranuar se, ankuesja nga momenti i emërimit në pozicionin “Edukatore”, në Kopshtin e Njesisë Administrative Orikum me datë 01.12.2016, dhe më pas nga data 02.10.2017 kur është emëruar në Kopshtin Nr. 3, Vlorë dhe deri në muajin shkurt 2023 është paguar me pagë grupi 14.000 lekë, ndërsa nga muaji shkurt 2023 e në vijim paguhet me pagë grupi 11.000 lekë.

Lidhur me ndryshimin e pagës së grupit, reflektuar në pagën e muajit shkurt 2023 e në vijim, ankuesja ka pretenduar për trajtim të padrejtë dhe diskriminues nga ana e Bashkisë Vlorë, për shkak të “gjendjes arsimore”.

Neni 28<sup>6</sup>, i ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 23<sup>7</sup>, i ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 4, e Urdhrit të Kryeministrit me nr. 127, datë 16.0.2015 “Për marrjen e masave në kuadër dhe në funksion të zbatimit të strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore”, kanë përcaktuar se, numri i punonjësve mësimorë/edukatorë të arsimit parashkollor, numri i punonjësve të shërbimeve në arsimin parauniversitar, si dhe fondet për mbulimin e shpenzimeve të punonjësve mësimorë, edukatorë të arsimit parashkollor, punonjësve të shërbimeve në arsimin parauniversitar, janë transferuar dhe janë në kompetencë të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Arsimi parauniversitar, është ristrukturuar, duke i kaluar në varësi të bashkive, gjithë punonjësit e kopshteve (edukatoret) dhe gjithë personelin mirëmbajtës të shkollave 9 vjeçare dhe gjimnazeve. Me buxhetin e vitit 2016, janë transferuar në nivel vendor funksionet e kompetencat lidhur me personelin mësimor dhe jo mësimor në arsimin parashkollor.

---

<sup>6</sup> Neni 28 “Njësia bazë e qeverisjes vendore”:

“1. Njësia bazë e qeverisjes vendore ka për detyrë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Kompetencat kryesore të njësisë bazë të qeverisjes vendore janë:

a) ndërtimi dhe rikonstruksioni i godinave të institucioneve arsimore publike, sipas standardeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me fonde të Buxhetit të Shtetit ose me fonde nga transfertat e pakushtëzuar ose të ardhurat e veta;

b) garantimi i paprekshmërisë së institucioneve arsimore në juridiksionin e saj, si dhe i mjediseve të tyre;

c) ruajtja dhe mirëmbajtja e institucionit arsimor publik;

ç) garantimi i kushteve higjieno-sanitare e atyre të ngrohjes në godinat e institucioneve arsimore publike.

3. Njësia bazë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me njësinë përkatëse arsimore vendore dhe institucionet arsimore publike, është përgjegjëse për regjistrimin e nxënësve në shkollat publike të arsimit të detyrueshëm me kohë të plotë.

4. Njësia bazë e qeverisjes vendore, mbështetur në propozimet e njësive arsimore vendore dhe këshillat e mësuesve të institucioneve, sipas kriteve të miratuara në këshillat e njësive vendore, mbështet:

a) nxënësit e familjeve në nevojë;

b) nxënësit me arritje të shkëlqyera;

c) punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin e tyre profesional dhe për zhvillimin e kurrikulës;

ç) pajisjen e institucioneve arsimore me mjete mësimore.

<sup>7</sup> Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike.

Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për... 12. Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.”

Vendimi i Qeverisë për decentralizimin e funksionit të arsimit specifikon transferimin e personelit mësimor në arsimin parashkollor (kopshte) dhe personelin jomësimor në arsimin parauniversitar. Në kuadër të decentralizimit të këtij funksioni, 7101 punonjës u transferuan nën kompetencat e bashkive në vitin 2016. Transferimi i shërbimeve arsimore së bashku me numrin e punonjësve që ofrojnë këto shërbime është shoqëruar me efektet financiare prej 4.3 miliard lekë.

Urdhri i Kryeministrit nr. 127, datë 16.09.2015, lidhur me transferimin e numrin e punonjësve në arsimin parashkollor, edukatore në kopshtet e fëmijëve, numrin e punonjësve të shërbimeve ndihmëse në arsimin 9-vjeçar ku përfshihet dhe numri i punonjësve të qendrave kulturore të fëmijëve, numrin e punonjësve të shërbimeve mbështetëse në arsimin e mesëm të përgjithshëm “gjimnazet”, ka përcaktuar dhe fondet e parashikuara për mbulimin e shpenzimeve të personelit (paga dhe sigurime shoqërore).<sup>8</sup>

Bazuar në sa më sipër, institucioni që ka kompetencën për pagën e punonjësve mësimorë/edukatorë në arsimin parashkollor është njësia vendore/bashkia. Në rastin konkret, objekt gjykimi është Bashkia Vlorë.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se përsa i takon pretendimit për uljen e pagës së grupit të edukatoreve të arsimit parashkollor, gëzon legjitimitet pasiv para KMD-së, vetëm Bashkia Vlorë dhe jo Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Për rrjedhojë, Bashkia Vlorë, në tagrin e institucionit përgjegjës lidhur me pagën e ankueses (punonjësve mësimorë/edukatorë në arsimin parashkollor), ka argumentuar se, (pavarësisht momentit të zbatimit të aktit nënligjor që përcakton pagën e grupit për punonjësit e arsimit parashkollor) një ndryshim i tillë në pagën e ankueses, ka ardhur si rezultat i zbatimit të VKM-së nr. 175, datë 08.03.2017 *“Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”*, për caktimin e pagave të punonjësve të arsimit parashkollor/edukatorëve, për pasojë edhe të ankueses si pjesë e kësaj kategorie.

Nga dokumentacioni i depozituar nga palët në proces, evidentohet se nga ana e Bashkisë Vlorë është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme përmes korrespondencës shkresore, nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, interpretim i kësaj VKM-je me qëllim zbatimin e saj korrekt dhe në përputhje me sa është përcaktuar.

- Me shkresën nr. 1024, datë 25.01.2023, Bashkia Vlorë i është drejtuar MAS, më kërkesën për interpretim lidhur me sa më poshtë vijon:
  - Me cilin grup të pagës do të paguhet një edukatore me diplomë “Bachelor” dega parashkollor 2006-2009 e cila ka qenë e punësuar dhe e siguruar në institucionet arsimore publike deri në datën 1 mars 2017, ka shkëputur marrëdhënien e punës tashmë po punësohet në një institucion arsimor publik pas hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 175, datë

---

<sup>8</sup> [https://www.bpe.al/sites/default/files/documents/Raport-Studimor-DLDP-Monitorim-i-I-Strategjia-Decentralizimit-te-QV-2016-1\\_0.pdf](https://www.bpe.al/sites/default/files/documents/Raport-Studimor-DLDP-Monitorim-i-I-Strategjia-Decentralizimit-te-QV-2016-1_0.pdf).

08.03.2017 *“Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”*.

- Me cilin grup të pagës do të paguhet një edukatore me diplomë “Bachelor” dega parashkollor 2006-2009 e cila ka qenë e punësuar dhe e siguruar në institucionet arsimore publike deri në datën 1 mars 2017, ka shkëputur marrëdhënien e punës tashmë po punësohet në një institucion arsimor publik, krahas diplomës “Bachelor” ka kryer edhe “Master Shkencor”.
  - Me cilin grup të pagës do të paguhet një edukatore me diplomë “Bachelor” dega parashkollor 2006-2009 e cila ka qenë e punësuar dhe e siguruar në institucionet arsimore publike, si psh Berat deri në datën 03.10.2022, dhe po në datën 03.10.2022 transferohet në portal dhe punësohet në një institucion arsimor publik në Vlorë dhe ka kryer “Master Profesional”;
  - Mësuese ndihmëse me diplomë “Bachelor” me “Master Profesional” paga e grupit 11.000 lekë apo 14.000 lekë?
- Në vijim të kërkesës së Bashkisë Vlorë, nëpërmjet shkresës me nr. 616/1, datë 08.02.2023, MAS, ka sqaruar ndër të tjera, Bashkinë, duke argumentuar se:
- Në lidhje me pagën e diplomës, VKM në fjalë, ka përcaktuar se: Punonjësit aktualë mësimorë/edukatorë të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë të studimeve universitare “Bachelor”, ose të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë deri para datës 1 mars 2017, kanë përfituar pagën e grupit në masën 14.000 lekë, do të vazhdojnë të përfitojnë të njëjtën masë të pagës së grupit deri në momentin e ndryshimit të nivelit të diplomës, apo ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me institucionin përkatës. Punonjësit mësimorë/edukatorë që fillojnë punën për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar pas datës 1 mars 2017, do të trajtohen me pagë grupi sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 2, të VKM-së.
  - Në përgjigje të pikës 1 dhe 4, të kërkesës tuaj, sqarojmë se, në zbatim të VKM-së në fjalë, është përcaktuar se: Punonjësit aktualë mësimorë/edukatorë të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë të studimeve universitare “Bachelor”, ose të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë deri para datës 1 mars 2017, kanë përfituar pagën e grupit në masën 14.000 lekë, do të vazhdojnë të përfitojnë të njëjtën masë të pagës së grupit deri në momentin e ndryshimit të nivelit të diplomës, apo ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me institucionin përkatës.
  - Në përgjigje të pikës dy dhe tre tuaj, sqarojmë se, bazuar në nenin 57, të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar, në këtë program arsimor (edukatore) nuk kërkohet kualifikimi i nivelit të dytë në “Master Profesional apo Shkencor”. Punonjësit arsimorë/edukatorë që fillojnë punë për herë të parë si edukatore në arsimin parauniversitar pas datës 1 mars 2017, do të trajtohen me pagë grupi sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 2, të VKM-së.
  - Ndaj sa më sipër, këkojmë nga ana juaj klasifikimin e pagave të punonjësve sipas VKM së nr. 175, datë 08.03.2017 *“Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”*.

- Me shkresën nr. 1024/2, datë 16.03.2023, Bashkia Vlorë i është drejtuar sërish MAS, lidhur me nevojën për të qartësuar qëndrimin, interpretimin e tyre, ndër të tjera, lidhur me, paragrafin: “...do të vazhdojnë të përfitojnë të njëjtën masë të pagës së grupit deri në momentin e ndryshimit të diplomës...”, duke informuar MAS, se:

*“... Jemi të paqartë lidhur me këtë paragraf, pasi në institucionet arsimore të Bashkisë Vlorë ka edukatore të cilat kanë përditësuar dosjen me diplomë “Master Shkencor” dhe “Master Profesional”, dhe pretendojnë të përfitojnë pagën e grupit në masën 14.000 lekë.”*

- Në përgjigje të sa më sipër, MAS, me shkresën nr. 616/3, datë 29.03.2023, ka dërguar pranë Bashkisë Vlorë të njëjtën përgjigje që ka përcjellë me datë 08.02.2023, me shkresën nr. 616/1 prot.

Është pranuar nga palët se, ndryshimi i masës së pagës së grupit për subjektin ankues është reflektuar për herë të parë (që nga emërimi i saj në detyrë me datë 02.10.2017) në muajin shkurt 2023.

Në lidhje me pagesën mujore të punonjësve të arsimit parashkollor/edukatorëve, për pasojë edhe të ankueses si pjesë e kësaj kategorie, sipas nivelit të arsimimit të tyre, Komisioneri vëren se, paga mujore e tyre, përllogaritet, mbështetur në kriteret e përcaktuara në pikën 3, të VKM nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, ku përcaktohet se, “Struktura e pagës mujore” përbëhet nga:

3. a) Paga e grupit (kolona 2 e lidhjeve nr. 1, nr. 2 e nr. 3), që është paga për nivelin arsimor të kërkuar, vlera e së cilës përcaktohet sipas lidhjes nr. 4, “Paga për nivelin arsimor”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

“Punonjësit aktualë mësimorë/edukatorë të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë të studimeve universitare “Bachelor”, ose të barasvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe deri para datës 1 mars 2017, kanë përfituar pagën e grupit në masën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë, do të vazhdojnë të përfitojnë të njëjtën masë të pagës së grupit deri në momentin e ndryshimit të nivelit të diplomës, apo ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me institucionin arsimor përkatës.

*Punonjësit mësimorë/edukatorë që fillojnë punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar pas datës 1 mars 2017, do të trajtohen me pagë grupi sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 4 të vendimit.”.*

3. b) Shtesa për vjetërsi pune (kolona 3 e lidhjeve nr. 1, nr. 2 e nr. 3), që aplikohet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, por jo më shumë se 25 vjet. Kjo shtesë llogaritet mbi pagën e grupit. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

3. c) Shtesa për kualifikim, (kolona 4 e lidhjeve nr. 1 e nr. 3). Kjo shtesë jepet sipas dëshmisë së kualifikimit individual dhe llogaritet mbi pagën e grupit, në përqindje, si më poshtë vijon: .....

3. ç) Shtesa e pozicionit, (kolona 5 e lidhjeve nr. 1, nr. 2 e nr. 3) është e përcaktuar për çdo vend pune, sipas emërtesës përkatëse të pozicionit të punës.

Lidhja nr. 4, e kësaj VKM-je, përcakton: “Paga për nivelin arsimor”, për edukatorët, sipas tabelës:

Grupi		Niveli i diplomës	Shuma lekë në muaj
Grupi 2	Mësues i arsimit parashkollor	Diplomë universitare të ciklit të parë të studimeve universitare “Bachelor” apo të barazvlefshme me to sipas udhëzimit të Ministrit përgjegjës për arsimin.	11.000

Ligji Nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 2 pika 5, parashikon se: “Institucion arsimor” është kopshti ose shkolla”.

Neni 57, i ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se: “Mësuesi për arsimin parashkollor duhet të ketë diplomën e ciklit të parë “Bachelor”, që formon mësues të arsimit parashkollor”.

Komisioneri vëren se, në lidhje me pagën sipas kriterit arsimor/diplomës së zotëruar, VKM me nr. 351, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime në “VKM nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, përcakton se:

“Punonjësit aktualë mësimorë/edukatorë, të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë të studimeve universitare “Bachelor”, ose të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe deri para datës 1 mars 2017, kanë përfituar pagën e grupit në masën 14.000 lekë, do të vazhdojnë të përfitojnë të njëjtën masë të pagës së grupit, deri në momentin e ndryshimit të nivelit të diplomës, apo ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me institucionin përkatës.

Punonjësit mësimorë/edukatorë që fillojnë punën për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar, pas datës 1 mars 2017, do të trajtohen me pagë grupi sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 2, të VKM-së”.



Në momentin e miratimit VKM Nr. 175, datë 8.3.2017, nuk përmbante asnjë diferencim midis punonjësve mësimorë/edukatorë, kushtëzuar nga fakti nëse ata kishin filluar punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar, para apo pas datës 1 mars 2017. Sipas VKM-së Nr. 175, datë 8.3.2017, të gjithë punonjësit mësimorë/edukatorë, do të paguheshin me pagë grupi 11.000 lekë. Rreth një muaj e gjysëm pas miratimit të VKM Nr.175, datë 8.3.2017, Këshilli i Ministrave miratoi VKM Nr. 351, datë 19.04.2017, akt nëpërmjet të cilit u vendos diferencimi i punonjësve mësimorë/edukatorë, si më sipër pasqyruar.

Komisioneri, bazuar në sa më sipër, konstaton se, lidhur me ushtrimin e profesionit si punonjës mësimor/edukator, nuk kërkohet kualifikimi i nivelit të dytë master, pra, punonjësit mësimorë në arsimin parashkollor, edukatorë, që zotërojnë diploma të nivelit të dytë “Master profesional” apo “Master shkencor”, dhe për rrjedhojë ata nuk përfitojnë shtesë page, pasi për emërimin në këtë pozicion nuk kërkohet një kualifikim i tillë.

Për analogji e njëjta logjikë arsyetuese vlen edhe për punonjësit mësimorë/edukatorë që fillojnë punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parashkollor pas datës 1 mars 2017.

Komisioneri, bazuar në sa më sipër, konstaton se, punonjësit edukatorë që deri para datës 1 mars 2017 kanë përfituar pagën e grupit në masën 14.000 lekë, do të vazhdojnë të përfitojnë të njëjtën masë të pagës së grupit, deri në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me institucionin përkatës, gjë që ka ndodhur dhe me ankuesen që ka vazhduar me të njëjtën pagë deri në datë 02.10.2017 kur ka qenë e punësuar si edukatore në Kopshtin Nr. 3, Vlorë.

Lidhur me situatën faktike të ankueses, Komisioneri vëren se, bazuar në deklaratimet e ankueses, si dhe Kontratat Individuale të Punës, rezulton se marrëdhënia e punës në pozicionin “Edukatore” në kopshtet e Bashkisë Vlorë, për E. Xh., ka nisur nga data 01.12.2016 deri në datë 23.08.2017, ku ka qenë e emëruar me kontratë me kohëzgjatje të caktuar, si edukatore në Kopshtin e Njesisë Administrative Oriku, Vlorë dhe në datë 02.10.2017 është emëruar si edukatore në Kopshtin Nr. 3, Bashkia Vlorë, fillimisht me kontratë 1-vjeçare (deri në datë 02.10.2018) dhe më pas ka nënshkruar kontratën individuale me afat të pacaktuar.

Pra, rezulton se që nga momenti kur ankuesja ka filluar punë si edukatore në datë 01.12.2016, ajo ka pasur shpërblyerje nga puna, pasi ka qenë e punësuar me kontratë pune me afat të caktuar dhe ka dalë nga sistemi arsimor parauniversitar publik.

Duke qenë se ankuesja ka ndërprerë marrëdhënien e punës me institucionet përkatëse arsimore ku ajo ka qenë e punësuar dhe ka lidhur kontratën e punës me afat të pacaktuar më datë 02.10.2017, konsiderohet si punonjëse që ka filluar punë për herë të parë në sistemin arsimor parauniversitar, pas datës 01.03.2017.

Rezultoni e faktuar se ankuesja në datë 02.10.2017 ka ndryshuar institucion arsimor nga Kopshti Oriku në Kopshtin Nr. 3, Vlorë dhe ky ka qenë momenti që është konsideruar nga Bashkia Vlorë si punonjës mësimorë/edukatorë që ka përfituar pagën e grupit në masën 14.000 lekë, deri në

momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me institucionin përkatës, pra me Kopshtin Orikum.

Rezulton e pranuar nga palët në këtë proces se, ankuesja nga momenti i fillimit të punës në pozicionin “Edukatore”, pranë Kopshtit Nr. 3, Vlorë, me datë 02.10.2017, e deri në muajin shkurt 2023 është paguar me pagë grupi 14.000 lekë.

Pas muajit shkurt 2023, rezulton të jetë paguar me pagë grupi 11.000 lekë.

Në analizë e konkluzion të sa më sipër, Komisioneri thekson se nga ana e Bashkisë Vlorë, si institucioni përgjegjës dhe kompetent lidhur me pagën e punonjësve mësimorë/edukatorë në arsimin parashkollor, për rrjedhojë edhe të ankueses, si edukatore në arsimin parashkollor, është zbatuar përcaktimi i mësipërm i aktit nënligjor<sup>9</sup> që ka përcaktuar edhe vlerën e pagës së grupit për këtë kategori të punonjësve mësimorë/edukatorë të cilët kanë nisur marrëdhënien e tyre të punës pas datës 1 mars 2017.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesja nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pafavorshme, nga ana e Bashkisë Vlorë, pasi, paga e saj është përlogaritur konform dhe në zbatim të përcaktimit të VKM-së respektive, sipërcituar në vendim, pavarësisht momentit se kur ka filluar zbatimin e këtij akti.

Komisioneri evidenton faktin se, ky akt nënligjor nuk është zbatuar nga ana e Bashkisë që nga hyrja e tij në fuqi, por gati 6 vite më vonë dhe se efektet negative financiare të shkaktuara nga moszbatueshmëria e tij në kohë, (qoftë në dëm të buxhetit të shtetit apo të subjektit ankues), nuk janë objekt i analizës të kësaj ankese, dhe për rrjedhojë nuk do t’i nënshtrohen shqyrtimit të tyre nga ana e KMD-së.

Komisioneri vëren se, zbatimi i akteve ligjore e nënligjore të dala për zbatim nga organet e institucionet përgjegjëse shtetërore, është detyrues për ta.

Për rrjedhojë, në shpjegim të sa më sipër dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrotjtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues, nisur nga kushtet e rrethanat objektive të rastit të saj, nuk i është nënshtuar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Vlorë.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Vlorë, ardhur për shkakun pretenduar nga ana e subjektit ankues.

**A. 2 Lidhur me ndryshimin e pagës së grupit, të ankueses/edukatorëve në arsimin parashkollor, sipas VKM-së nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar.**

<sup>9</sup> Pika 3.a), e VKM nr. 175, datë 08.03.2017 “*Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar*”.

Bazuar në deklaratimet e palëve, si dhe nga këqyrja e dokumentacionit të depozituar, rezulton se, subjekti ankues ka lidhur marrëdhënien e saj të punës si “Edukatore”, pranë Kopshtit Nr. 3, Vlorë, me datë 02.10.2017, dhe deri në muajin shkurt 2023 është paguar me pagë grupi 14.000 lekë.

Nga muaji shkurt 2023 e në vazhdim paguhet me pagë grupi 11.000 lekë.

Sipas analizimit të bërë në pikën A.1, të këtij vendimi, është konkluduar se zbritja që i është bërë pagës së grupit të ankuses, ka ardhur si rezultat i zbatimit të aktit nënligjor që përcakton pagën e punonjësve arsimorë/edukatorëve, respektivisht pikën 3/a), të VKM nr. 175, datë 08.03.2017 “*Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë, në arsimin parauniversitar*”, të ndryshuar.

Në analizë të parashikimit të kësaj VKM-je, vërehet se, pika 3/a) e këtij akti, *apriori*, bën një diferencim në përcaktimin e pagës së grupit, ndërmjet punonjësve mësimorë/edukatorë që fillojnë punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar para datës 1 mars 2017, dhe atyre që kanë filluar punë pas kësaj date. Ku për kategorinë e parë paga e grupit është përcaktuar 14.000 lekë, ndërsa për kategorinë e dytë paga e grupit është përcaktuar 11.000 lekë.

Bazuar në sa më sipër, *prima facie*, evidentohet qartë se VKM-ja në fjalë, i dallon dhe trajton në mënyrë të diferencuar e të pabarabartë këto dy kategori punonjësish/edukatorë, duke e lidhur këtë diferencim me momentin kur ata kanë lidhur marrëdhënien e punës për herë të parë: para dhe pas datës 01.03.2017.

Lidhur me arsyetimin e sipërcituar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të shqyrtimit të ankesës iu drejtua Këshillit të Ministrave me anë të shkresave nr. 660/4 prot., datë 26.09.2023 dhe nr. 660/6 prot., datë 06.11.2023, për të marrë informacion/relacion shpjegues lidhur me arsyet e diferencimit të mësuesve/edukatorëve për përfitimin e pagës së grupit sipas VKM-së nr. 175, datë 08.03.2017 “*Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë, në arsimin parauniversitar*”, të ndryshuar. Gjithashtu përmes shkresave të sipërcituara, Komisioneri kërkoi të informohet lidhur me arsyet e vendosjes së këtij diferencimi, që lidhet me datën e zbatimit të VKM-së nr. 175, datë 08.03.2017. Për sa më sipër, Këshilli i Ministrave nuk vuri në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion sa u kërkuar lidhur me ankesën në shqyrtim.

Në këtë kuptim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nuk arriti të administrojë informacionin e nevojshëm për të analizuar arsyet përse Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM-në nr. 175, datë 08.03.2017 “*Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë, në arsimin parauniversitar*”, e ndryshuar, duke diferencuar punonjësit mësimorë/edukatorë që fillojnë punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar para datës 1 mars 2017, dhe atyre që kanë filluar punë pas kësaj date, ku për kategorinë e parë paga e grupit është përcaktuar 14.000

lekë, ndërsa për kategorinë e dytë paga e grupit është përcaktuar 11.000 lekë. Sakaq, VKM-ja e sipërcituar, evidentohet se nuk është e qartë dhe e kuptueshme nga organet të cilat vendosen përpara përgjegjesisë për ta zbatuar atë. Duke qenë e paqartë, vendos përpara vështirësisë institucionet/organet përgjegjëse në sjelljen që duhet të mbajnë për zbatimin e saj.

Në analizë për sa më sipër, Komisioneri konstaton se VKM-ja nr. 175, datë 08.03.2017 “*Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë, në arsimin parauniversitar*”, e ndryshuar, krijon dyshim të arsyeshëm se ka vënë përpara një situatë të pabarabartë dhe diferencuese kategoritë e punonjësve mësimorë/edukatorë të cilët kanë filluar punë përpara datës 1 mars 2017 dhe pas kësaj date.

Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në respektim të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, rekomandon Këshillin e Ministrave të rishikojë dhe të formulojë në mënyrë objektive, të justifikuar, të qartë dhe proporcionale parashikimet e VKM-së nr. 175, datë 08.03.2017 “*Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë, në arsimin parauniversitar*”, të ndryshuar, duke pasur në vëmendje trajtimin e barabartë të kategorive të punonjësve mësimorë/edukatorë të cilët kanë filluar punë përpara datës 1 mars 2017 dhe pas kësaj date.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, E. Xh., nga ana e Bashkisë Vlorë, për shkakun e pretenduar prej saj.
2. Rekomandohet Këshilli i Ministrave, që në respektim të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, të marrë masat për rishikimin dhe riformulimin në mënyrë objektive, të justifikuar, të qartë dhe proporcionale, të parashikimeve të VKM-së nr. 175, datë 08.03.2017 “*Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë, në arsimin parauniversitar*”, së ndryshuar, duke pasur në vëmendje trajtimin e barabartë të kategorive të punonjësve mësimorë/edukatorë të cilët kanë filluar punë përpara datës 1 mars 2017 dhe pas kësaj date.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

## **KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Gjendja Arsimore)  
(Fusha: Punësim)